



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:160938  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05730503

**Ac.nr.7924/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj e Besnik Feka - anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëseve P.K, nga fshati ,, , të cilën e përfaqëson perfaqsesi ligjor, B.K, ndërsa me autorizim i përfaqëson V.S, av. nga ,, , kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “Eurosig”, me seli ne Prishtine, të cilën me autorizim e përfaqëson F.M, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, - dega në Lipjan, C.nr.465/2018, të datës 04.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimit “Eurosig”, me seli ne Prishtine, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, - dega në Lipjan, C.nr.465/2018, i datës 04.06.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.465/2018, të datës 04.06.2021, me pikën *I (një)* të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses P.K, nga fshati ,, , si të bazuar dhe e ka obliguar të paditurën Kompania e sigurimit “Eurosig”, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 18.10.2018, në rrugën “Avdi Kelmendi”, në Lipjan, t’ia paguaj shumat si vijon: 1. Dëmin jo material a) në emër të dhimbjeve fizike- trupore, shumën prej 1,300,00.-€, b) në emër te frikës se përjetuar, shumën prej 1,100,00.-€, 2. Dëmin material a) në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 98.00.-€, b) në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë shumën prej 85,00.-€, c) në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej 28.70€, -të gjitha këto shuma, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 04.06.2021, e deri

te pagesa definitive. Në pikën *II (dy)* të dispozitivit, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, më tepër se shumat e aprovuara, si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dhe kërkesëpadia e paditëses për rehabilitim klimatik në shumë prej 182.00€, janë refuzuar si të pa bazuara. Në pikën *III (tre)* të dispozitivit është obliguar e paditura t'ia paguaj palës paditëse shumat nga pika I, e këtij aktgjykimi si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 853.60.-€, të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, e paditura ka paraqitur ankesë për shkak të *zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, të aprovoj si të bazuar ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që pjesën e gjykuar ta zvogëloj duke u bazuar në nenin 195.1 shkronja e) të LPK-së.

Paditëset nuk kanë parashtruar as ankesë, e as përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e të paditurës, është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes të autorizuarit të tyre, me datën 06.12.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të palëve ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.465/2018, të datës 04.06.2021, me të cilin kërkesëpadia e paditëses është aprovuar pjesërisht si e bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit në fjalë. Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se mbi bazën e provave të administruara, si Ekspertizës së Komunikacionit Rrugor të hartuar në lëndën kontestimore të gjykatës së shkallës së parë C.nr.479/2018, nga eksperti S.SH, Raportit të aksidentit të komunikacionit rrugor, aktgjykimit penal të kësaj gjykate P.nr.738/18 te dt.26.12.2018 dhe vlerësimit të ekspertëve gjyqësor nga lëmi i Ortopedisë-Traumatologjisë dhe Psikiatrisë, e të cilave prova gjykata ua fali besimin dhe fakteve jokontestuese në mes palëve ndërgjyqësore, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se aksidenti në komunikacionin rrugor të datës 18.10.2018, në rrugën “,,”, në Lipjan, përkatësisht tek lokali “,,”, është shkaktuar me lëshimet primare të ngasësit të automjetit të tipi “,,”F.R, me 80% të lëshimeve dhe me kontributin e paditëses prej 20%, në atë mënyrë, që përderisa ngasësi ishte duke drejtuar automjetin në drejtim të qendrës së qytetit, me të arritur tek lokali “,,”, duke mos qenë i kujdesshëm gjatë ngasjes, duke mos i kushtuar vëmendje pjesëmarrësve të tjerë në trafik, në këtë rast këmbësore P.K, gjegjësisht duke mos reaguuar në kohë dhe hapësirë të caktuar, me që rast në kalim e sipër me pjesën anësore të djathtë të automjetit kishte goditur këmbësoren e cila kishte qenë duke e kaluar rrugën nga ana e djathtë në të majtë, shikuar nga drejtimi i lëvizjes së automjetit, e në të cilin aksident ka kontribuar edhe paditësja prej 20%, e cila ka bërë kalim të pasigurtë të

rrugës, pasi në vendin ku ka ndodhur aksidenti nuk ka pasur vendkalim për këmbësor, dhe mbi këtë bazë, e konform nenit 136, nenit 159 dhe nenit 169, të LMD-së dhe mbi bazën e përgjegjësive të kontraktuar, rrjedh obligimi i të paditurës që konform lëshimeve të ngasësit të automjetit të siguruar nga autopërgjegjësia prej 80% në shkaktimin e aksidentit në komunikacion, t'ia kompensojë edhe dëmin e shkaktuar material dhe jo material paditëses.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo ngase me nenin 136 par.1 të LMD së zbatuar për këtë rast (Nr.04/L-077), parashihet se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Ndërsa në nenin 159 par.1 të LMD-së parashihet se “*Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit*”. Më nenin 169 par.1 të këtij ligji parashihet se “*Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi*”. Poashtu neni 179 par.1 parasheh se “*Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit*”. Kurse me nenin 183 par.1 të LMD, parashihet se “*Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material*”. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimit, gjykata është e mendimit se e njëjta është e adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses si dhe shkallën e të mirës nga e cila ajo është privuar dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarës - këtu paditëses, satisfaksion që ajo me këto mjete t'i riparojë në një masë nevojat e saj materiale. Gjithashtu, sa i përket lartësisë së shumave të aprovuara gjykata e shkallës së parë është mbështetur në nenin 323 të LPK-së, i cili decidivisht thotë se “*Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhet me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë*”. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vendosur konform kësaj, duke vendosur shumën e mjaftueshme, që i përgjigjen shkallës së

nevojës për kompensim për këto lëndime. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit i refuzon si të pa bazuara pretendimet ankimore lidhur me këto.

Në raport me shpenzimet e mjekimit, gjykata e shkallës së dytë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur i ka aprovuar në tërësi shpenzimet e mjekimit sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ngase të njëjtat janë të bazuara dhe provuara me prova konkrete të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e të cilave ua fali besimin e plotë edhe gjykata e shkallës së dytë.

Ndërsa, sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të huaj, e cila po ashtu është vërtetuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të huaj, atëherë vërtetohet se të dëmtuarës i takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së. E drejtas materiale është zbatuar drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore - kamatës.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë pa ndikim për ndonjë vendim tjetër nga sa u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të lartcekurave, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur në këtë çështje kontestimore, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.7924/21, datë 23.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**